

Mendim paralel

1. Unë, anëtari i trupit gjykues Roland Ilia, për çështjen e subjektit të rivlerësimit Flojera Davidhi, kam votuar pro qëndrimit të mbajtur në vendimin e trupit gjykues, për sa i përket vendimmarrjes lidhur me të tria kriteret e vlerësimit - me kriterin e vlerësimit profesional në veçanti, si dhe konfirmimin në detyrë të subjektit.
2. Edhe pse të gjitha argumentet e arsyetuara në vendim, legjitimojnë dhënien e vendimit për konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit Flojera Davidhi, jam shprehur kundër qëndrimit të trupit gjykues në shumicë, për sa i përket një çështjeje që lidhet me vlerësimin profesional të subjektit. Kjo pasi shumica ka vendosur: *“...transferimin pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore për çështjen me numër regjistri themeltar ***, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 1.4.2019”*.
3. Ky qëndrim, ndonëse nuk afekton vendimmarrjen e Komisionit, lidhet me një arsyetim të ndryshëm rreth zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi dhe vlerësimit ndryshe në veçanti, nga ana ime si anëtar i trupit gjykues, për këtë çështje.
4. Konkretisht, shumica në përfundim të gjykimit ka vendosur transferimin e çështjes nr. ***, datë 1.4.2019, pranë organit kompetent për inspektim me arsyetimin dhe duke pasur parasysh:
 - *fenomenin e korrupsionin në vendin tonë;*
 - *ndjeshmërinë e publikut në këto raste; si dhe*
 - *faktin nëse çështja në fjalë, duket se mund të kishte pasur një trajtim edhe më ndëshkues për të pandehurën, e cila është kapur në flagrancë duke marrë një shumë parash në zyrën e saj, në këmbim të një shërbimi publik.*
5. Bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të magjistratit.
6. Për të konstatuar shkeljet e mundshme të magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës dhe më pas për të vlerësuar dhe adresuar këto shkelje duhen mbajtur parasysh dispozitat ligjore në fuqi që normojnë dhe rregullojnë këtë fushë.
7. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratit”, në neni 101 “shkeljet disiplinore dhe çështjet e veprimtarisë” neni 102 “shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit”, ka përcaktuar veprimet dhe sjelljet e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore.
8. Në mbështetje të parashikimeve germës “a”, të pikës 2, të nenit 140, të Kushtetutës, nenet 3, 4, 101, 103, paragrafi 1, germa “dh”, 105, 115, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim identifikimin e elementeve juridikë dhe faktikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi disiplinor, paraprakisht vlerësohet se gjatë procesit

hetimor duhet të analizohen nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën ose jo shkelje disiplinore.

9. Në analizë të çështjes, nëse nga ana e magjistratit, janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e saj profesionale në mbështetje pikës 2, të nenit 101, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, merren parasysh një sërë faktorësh si:
 - a) *shkalla e pakujdesisë (fajësisë);*
 - b) *shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;*
 - c) *përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;*
 - d) *dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe*
 - e) *çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.*
10. Në pikën 1, të nenin 115, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohen në mënyrë jo shteruese, si kritere për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.
11. Në vendim nuk evidentohet, analizohet apo referohet ndonjë shkelje konkrete e kryer nga subjekti për çështje të veprimtarisë apo në lidhje me ushtrimin e funksionit, por shkeljet e supozuara janë lënë në mënyrë evazive në këtë vendim.
12. Duhej që në vendim të ishin konstatuar dhe renditur shkeljet e kryera nga subjekti, duke ju referuar legjislacionit për statusin e magjistratit dhe, më pas, të arrihej vlerësimi dhe përfundimi që subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje të cilat nga Komisioni nuk konsiderohen në atë masë për të penalizuar subjektin dhe pastaj ta dërgojë çështjen për inspektim.
13. Në kuptimin formal, nuk është kryer një analizë ose shqyrtim autonom për të vlerësuar aftësinë profesionale të subjektit në këtë çështje gjyqësore.
14. Nga analiza e fakteve dhe provave të administruara në kuadër të këtij procesi hetimor, me qëllim identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë ekzistencën e shkeljes disiplinore, rezulton se në rastin konkret nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik.
15. Mos evidentimi i shkeljes së kryer nga subjekti i rivlerësimit del dhe nga vetë vendimi ku në përfundim është referuar se: “*Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e dhëna me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, çmon se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për*

inspektim, për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ose nëse ka shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit”.

16. Nuk mund të dilet në vendimmarrje duke hamendësuar se subjekti ka kryer shkelje disiplinore apo nëse ka shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit. Vetë ky formulim shfaq kontradikta, pasi nga njëra anë theksohet se subjekti mund të ketë kryer veprime që përbëjnë shkelje disiplinore nga ana tjetër theksohet se nëse ka shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik. Këto janë dy nocione të ndryshme dhe trupi gjykues duhet të kishte evidentuar shkeljen konkrete dhe vlerësuar më pas nëse mund të përbënte shkelje disiplinore apo duhet t'i dërgohej organit kompetent për vlerësim profesional për t'u marrë në konsideratë në sistemin e vlerësimit “Raportin periodik për sistemin e vlerësimit të magjistratit”. Vendimi i Komisioni duhet të jetë i saktë i plotë dhe pa supozime, por i arsyetuar lidhur me veprimet konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
17. Vendimi i shumicës nuk mund të kalojë dhe të referojë një çështje për shkelje të presupozuar të kryer nga magjistrati, duke u nisur nga fenomeni i korrupsionit në vendin tonë, ndjeshmërinë e publikut në këto raste, si dhe faktin nëse çështja në fjalë duket se mund të kishte pasur një trajtim edhe më ndëshkues për të pandehurën.
18. Duket pak abstrakte vlerësimi i shumicës se duke marrë në konsideratë fenomenin e korrupsionit, ndjeshmërinë e publikut apo faktin e një vendimmarrje ndryshe të subjektit të rivlerësimit, arrihet në konkluzion që subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje që mund të referohet si gjetje dhe të kërkohet vlerësimi nëse ka shkelje disiplinore apo të përfshihet në sistemin e vlerësimit.
19. Në përfundim të këtij arsyetimi, çmoj se elementet e mësipërme, të përdorura si bazë për të konkluduar se subjekti ka kryer shkelje disiplinore, nuk kanë një natyrë e peshë të tillë, të aftë për të shkaktuar perceptimin e publikut se drejtësia nuk funksionon. Nënvizojë faktin se qëndrimet që mbahen në raport me këtë qasje, duhet të jenë të arsyetuara e të analizuara, duke shpjeguar shkeljet dhe mënyrën se si ato cenojnë potencialisht besimin e publikut, me qëllim shmangien e subjektivizmit dhe vlerësimit sipërfaqësor të këtij vlerësimi.
20. Lidhur me vendimmarrjen ndryshe që duhej të bënte subjekti për këtë çështje jam i mendimit se shumica bie në kundërshtim me trajtimin që ka bërë vetë në këtë vendim, por dhe me vendimmarrjen e Kolegjit të Apelimit për çështje analoge (vendimi nr. ***, datë 13.7.2020, vendimi nr. *** datë 23.10.2020).
21. Vendimi i shumicës është bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku theksohet se Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson. Në këtë rast trupa në shumicë ka vendosur së vendimmarrja e subjektit nuk është e drejtë dhe se duhet të kishte një vendimmarrje tjetër (të kishte pasur një trajtim edhe më ndëshkues për të pandehurën). Duke bërë këtë analizë shumica ka gjykuar

vendimmarrjen e subjektit dhe vendimin e dhënë në bazë të provave fakteve dhe bindjes së saj të brendshme.

22. Në këtë aspekt, duhet konsideruar dhe vlerësuar dhe fakti se vendimi i subjektit të rivlerësimit është lënë në fuqi nga një gjykatë më e lartë. Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 22.7.2020, ka lënë në fuqi vendimin e subjektit duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë tërësore të rrethanave dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka vlerësuar me të drejtë se në raport me përmbajtjen e dispozitës penale, neni 259 të Kodit Penal, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, veprimet konkrete të kryera nga ana e të pandehurës në rastin konkret, nuk përmbushin elementet e kësaj figure të veprës penale.
23. Gjithashtu, shumica nuk ka konstatuar gjetje gjatë procesit të rivlerësimit për çështjen në fjalë të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, por ka marrë *indicie* nga mediat *on-line* lidhur me rastin e gjykimit të shtetasës V. B., e cila akuzohej për veprën penale të “*Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”. Kjo çështje është bërë publike që në datën 8.10.2018, nga emisioni investigativ “***”, televizioni “***”. Nuk është hetuar nëse kjo çështje është ndjekur apo jo nga organi kompetent për inspektim pasi është bërë publike që në vitin 2018. Gjithashtu, për shkak të marrjes dijeni nga fakte publike organet kompetente të inspektimit kanë detyrimin ligjor të ndjekin apriori procedurat e vlerësimit dhe inspektimit për shkeljet e mundshme të kryera ose jo nga magjistrati gjatë ushtrimit të detyrës.
24. Në përfundim shprehem se nuk duhet të ishte vendosur nga shumica: “*transferimi pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore për çështjen me numër regjistri themeltar ***, përfunduar me vendimin nr. **, datë 1.4.2019*”.

Roland Ilia
Anëtar